

KLARA KODRA

**BESNIKËRI DHE FANTAZI NË PASQYRIMIN
E EPOKËS DHE FIGURËS SË SKËNDERBEUT
NË LETËRSINË ARBËRESHE**

Problemi i pasqyrimin të epokës dhe figurës së Skënderbeut në letërsinë arbëreshe është marrë në shqyrtim nga studiues të ndryshëm si Markiano, Gualtieri, Shuteriqi, Xhaxhiu, gjithashtu edhe nga ne në artikuj, kumtesa, studime. Ky problem po shihet tani në dritë të re duke vështuar raportin midis pasqyrimin të realitetit historik në kuptimin e *mimesis* (riprodhimin sa më besnik të këtij realiteti) dhe shndërrimit artistik në bazë të idealit të shkrimtarëve.

Besnikëria e ngushtë ndaj historisë nuk është e domosdoshme në një krijim letrar të llojit historik, po në kushtet e sotme lexuesi më i përgatitur nuk e pranon më deformimin arbitrar të historisë nga ana e shkrimtarëve në bazë të fantazisë së tyre (pasqyrim ngjarjesh të paqena, heshtje ndaj ngjarjeve reale, idealizim i tepruar apo mitizim i figurave historike apo nxirje e tyre).

Natyrisht duhet të kihet parasysh poetikat e atyre drejtimeve letrare që i japin më tepër vend fantazisë dhe idealizimit, siç ishte në fakt romantizmi në letërsinë arbëreshe, pra caqet estetike. Nga ana tjetër nuk duhet të lihet mënjanë as çështja e varfërisë apo pasaktësisë së burimeve historike. Trajtimi i epokës dhe figurës së Skënderbeut në letërsinë e arbëreshëve të Italisë pati dy burime kryesore: historinë e Skënderbeut të Barletit dhe këngët popullore të cilat e trajtuan epokën dhe figurën e heroit në frymën e Rinashimentos evropiane dhe estetikës së folklorit, pra të idealizuara ndonëse ekziston një thelb objektiv, meqenëse është fjala për një rast ku realiteti ia kalon së tepërmi fantazisë, madje fantazisë së shkrimtarëve, i kërkohet të jetë në lartësinë e këtij realiteti të madhërishtë siç ishte lufta e një populli të vogël kundër një superfuqie të armatosur me armatimet më të fuqishme të kohës dhe bashkimi i një kombi të përçarë për një çerek shekulli. S'duhet harruar edhe roli i kësaj lufte në shpëtimin e Europës dhe kulturës së saj dhe meritat e atij udhëheqësi që e bëri të mundur.

Lëvizja Kombëtare e Rilindjes e rimori këtë figurë dhe këtë epokë të pasqyruar deri atëherë nga historianë shqiptarë dhe të huaj dhe gjithashtu nga shkrimtarë të huaj nga kombe të ndryshëm. Pikërisht në këtë periudhë figura e Skënderbeut ka një fuqi të jashtëzakonshme rrezatuese si simbol polivalent: simbol i identitetit kombëtar, simbol i bashkimit, simbol i një udhëheqjeje

popullore i idealit moral të “princit ose mbretit të ndritur” të iluministëve, simbol i një lidhjeje me kulturën evropiane dhe i meritave të kombit shqiptar përballë Europës.

Letërsia synoi ta shndërronte këtë simbol në personazh të gjallë, në individin e jashtëzakonshëm të romantikëve, që jepet edhe si zëdhënës i popullit.

Hajneja vë re me mprehtësi “trill i çuditshëm i popullit: ai e pretendon historinë e vet nga dora e poetit në vend të asaj të historianit”. Dhe, në fakt, s’është fjala për një trill aq të çuditshëm, sepse poezia dhe në përgjithësi letërsia ia rikthen ngrohtësinë e jetës epokave dhe figurave të së kaluarës që historiani i riprodhon me saktësi të ftohtë.

Siç e thamë edhe më lart, lloji historik është një lloj hibrid midis së vërtetës historike dhe “fiction”. Largimet nga realiteti janë të pashmangshme, po mendojmë se ato nuk duhet të jenë të tilla sa ta deformojnë të vërtetën historike në thelbin e vet objektiv.

Do të kemi gjithashtu parasysh një dukuri që evidencohet nga Osip Briku në artikullin e vet “Më afër me faktin”, i cili përfshihet në veprën e Maria Zalambanit “Vdekja e romanit” “dhjetë portrete të personave të *ndryshëm* që i bën *po ai* artist ngjajnë, ndërsa dhjetë portrete të një njeriu të *vetëm* të bëra nga *dhjetë* artistë të ndryshëm nuk ngjajnë”.

Pra, figura e Skënderbeut, e vizatuar nga shkrimtarë të ndryshëm arbëreshë, ka dallime në përputhje me individualitetin e tyre krijues dhe “vizionin e tyre të jetës”. Megjithatë këto portrete të ndryshëm të heroit në vepra të ndryshme i bashkon një thelb objektiv.

Shkrimtarët arbëreshë qenë të parët që themeluan traditën rilindëse të pasqyrimin të figurës dhe epokës së Skënderbeut, meqenëse për ta heroi mishëronte edhe një hallkë lidhëse të çmuar me dheun e të parëve.

Shkrimtarët arbëreshë e vizatuan Skënderbeun në radhë të parë si udhëheqës (ushtarak dhe burrë shteti), mbrojtës të popullit shqiptar, po njëkohësisht të krishterimit dhe të Europës. E pasqyruan në marrëdhënie të ngushta me popullin dhe gjithashtu në luftë kundër përçarjes feudale. Ata u përpoqën, gjithashtu, të zbulonin tek ai njerëzoren (ta pasqyrojnë si bir, vëlla, shok, burrë të dashuruar, baba, bashkëshort).

Në këtë drejtim u shqua De Rada si poet psikolog e në thelb lirik që fshihte në vetvete edhe një potencial dramatik. Shkrimtarët e tjerë (G. Dara, K. Serembe, B. Bilota, Noçiti) u përqendruan më tepër në aspektin qytetar duke thelluar ngjyresën historike dhe fillesën epike në vizatimin e figurës së Skënderbeut. Shkrimtarët arbëreshë të Rilindjes arritën edhe në realizimin *estetik* të kësaj figure, tipar i rëndësishëm i letërsisë arbëreshe ky. Vetëkuptohet që ky realizim u arrit te poetë të shquar si De Rada dhe Dara, kurse te poetët minorë, ndonëse afrimi me të vërtetën historike është më i madh, realizimi në fjalë është më i zbehtë.

Mund të flitet për një evolucion në letërsinë arbëreshe në dhënien e ngjyresës historike në përputhje me thellimin e frymës epike dhe heroike në vizatimin e figurës së heroit kombëtar.

Ato tipare që e dallonin figurën e Skënderbeut në folklor dhe në veprën e Barletit u thelluan dhe u fuqizuan në letërsinë artistike. Shkrimtarët ushtruan aftësi përzgjedhëse duke zgjedhur secili prej tyre për të pasqyruar disa nga këto tipare. Gjinia e zgjedhur për vizatimin e figurës së heroit që poezia për potencialin e saj të lartë emocional dhe aftësinë për komunikim të menjëhershëm me publikun arbëresh dhe italian, ndërsa lloji i parapëlqyer që poema si e vetmja formë e denjë për të lartësuar personalitetin e Gjergj Kastriotit. Megjithatë figurën dhe emrin e Skënderbeut e gjejmë edhe në llojet e vogla të poezisë. Në gjini të tjera të lëvruara nga shkrimtarët arbëreshë si proza dhe dramaturgjia mungon figura e Skënderbeut si personazh konkret, po është e pranishme fryma e epokës së tij, madje edhe emri i tij.

Filli i padukshëm që i bashkon të gjitha poemat e arbëreshëve të Italisë që i kushtohen heroit është theksimi i lidhjes së tij me masat popullore, paraqitja e tij si udhëheqës popullor. Ndonëse romantikët anonin nga kulti i individit të jashtëzakonshëm, prirja patriotike dhe demokratike e lëvizjes kombëtare i shtynte shkrimtarët ta shihnin individin si zëdhënës të kombit, të popullit, pra, jo një individ që ngrihet mbi të tjerët në saje të veçorive të veta të jashtëzakonshme, talentit apo gjenialitetit, po një individ që interpreton vullnetin e popullit dhe e drejton atë.

Në qoftë se Tolstoi e lartësonte popullin mbi individin dhe e pasqyronte një udhëheqës popullor si Kutuzovin si pasiv në kuptimin që lejon të veprojnë forcat e brendshme, që drejtojnë historinë, pra, forcën e masave më tepër se sa t'i drejtojë ato, rilindësit tanë kishin një koncept më të drejtë për raportin midis individit dhe masave, duke e pranuar rolin e tij aktiv dhe drejtues në funksion të ndërgjegjësimit të tij për interesin e kombit dhe të popullit.

Poetë si De Rada dhe Dara i ngrenë lart virtytet e njerëzve të thjeshtë të popullit, megjithatë prozhektori i tyre poetik drejtohet edhe nga aristokracia e kohës së cilës në përputhje me historinë i jepet një rol drejtues.

Gjithashtu ata e dënojnë me rreptësi përçarjen në gjirin e asaj aristokracie, prirjet e tyre separatiste, dallimet midis Veriut dhe Jugut, përçarje kundër së cilës, si nënvizohet, Skënderbeu lufton dhe krahas tij personazhe të tjera.

Shkrimtarë të tjerë minorë si Bernard Bilota, Kozmo Serembe dhe Engjëll Noçiti venë në qendër të tyre popullin e thjeshtë, barinjte, malësorët duke i përfaqësuar kryesisht përmes skenave masive.

De Rada në fakt dallohet ngaqë është poeti arbëresh i cili e paraqet figurën e Skënderbeut në shumanshmërinë më të madhe të aspekteve të ndryshëm të personalitetit të tij: si atdhetar që kërkon identitetin e vet kombëtar, si udhëheqës dhe luftëtar, si burrë shteti që synon krijimin e një

shteti të bashkuar shqiptar dhe gjithashtu në aspektin e vet thjesht njerëzor, si bir, si vëlla dhe si njeri i dashuruar. Ky poet i shquar është gjithashtu i vetmi që e paraqet Skënderbeun në mënyrë dinamike dhe dialektike përmes evolucionit të tij shpirtëror. Ai nënvizon që heroi kombëtar bëhet i tillë përmes një pjekurie të ngadalshme gjatë së cilës ai ndërgjegjësohet për misionin e vet historik. Ai pasqyron momentin në të cilin dëshira për lavdi shndërrohet në dëshirë për të çliruar kombin e vet të robëruar dhe ndjenja e natyrshme e hakmarrjes për vëllezërit që i vdesin të helmuar me urdhër të sulltanit, shndërrohet në dëshirë për t'u hakmarrë për kombin e vet. Këtë kthesë që ngjet në shpirtin e heroit dhe që poeti e pasqyron përmes një mjeti shprehës, që paralajmëron teknikat e mëvonshme moderne, monologut të brendshëm, e gjejmë në poemën e tij “Skanderbeku i pafan” për të cilën është thënë, jo aq saktë, se Skënderbeu është më tepër mungues se i pranishëm. Në të vërtetë heroi nuk është protagonist i poemës, po shfaqet në episode dhe situata kuptimplote që hedhin dritë mbi karakterin e tij.

Poeti i qëndron besnik historisë kur merr nga Barleti dy episode domethënës, episodin e helmimit të vëllezërve të Skënderbeut dhe episodin e luftimit të tij me dy tartarë. Episodi i parë shihet në funksion të zgjimit të urrejtjes në shpirtin e heroit ndaj otomanëve, i dyti për të nënvizuar aftësitë e tij si luftëtar si forca e jashtëzakonshme fizike dhe mjeshtëria në përdorimin e shpatës si edhe trimërinë që e nxit në një luftim të pabarabartë.

Në episodin e luftimit me tartarët evidencohet një detaj, shenja e kryqit që heroi bën para luftimit dhe që tingëllon si një sfidë para sulltanit dhe oborrtarëve.

Ky gjest, nënvizohet nga poeti, s'është vetëm shprehje e ndjenjës fetare, dëshmi e besnikërisë së tij të fshehtë ndaj fesë së të parëve, po edhe afirmim i përkatësisë së tij ndaj kombit shqiptar.

Poeti shton në poemë edhe një linjë që është krejt fryt i fantazisë, fillimin e një ndjenje dashurie ndaj princeshës Frosina që ndodhet në oborrin e sulltanit dhe që shprehet në episodin e shpëtimit të vajzës ndaj një elefanti që e kishte sulmuar. Kjo linjë ka domethënie e zbulimit të aftësisë së heroit për një dashuri të thellë e të pastër si edhe ballafaqimin e figurës së heroit me një karakter të kundërt siç është i biri i sulltanit që dallohet nga zilia dhe pabesia.

Te De Rada gjejmë një nuancë të veçantë në konceptimin e figurës së Skënderbeut. Në përputhje me botësoditjen e poetit heroit i atribuohen shqetësime ekzistenciale, shqetësimi për problemin e së keqes që bën t'i lindin dyshime për drejtësinë e Perëndisë. Ndofta ky është një modernizim i tepruar i figurës së heroit që e afron me intelektualët romantikë të shek. XIX dhe nuk i përshtatet atij, bir i një shekulli kur mbizotëronte veprimi dhe, historikisht, njeri i veprimit *par excellence*. Megjithatë edhe ky moment dyshimi, edhe ato çaste meditimi për problemet e mëdha filozofike të jetës (momente që kapërcehen shpejt nga heroi i cili nuk bie në pesimizëm, po vendos të luftojë me ngulm

kundër padrejtësive), e bën Skënderbeun e De Radës më të gjallë dhe njerëzor. Është interesante që më vonë Naimi filozof dhe mistik nuk e sheh heroin kombëtar në një optikë të tillë.

Figura e Gjergj Kastriotit jepet nga De Rada jo vetëm brenda caqeve të një poeme, po edhe në dy poema të tjera të lidhura me të parën nga një fill i përbashkët subjekti dhe kronologjie që pasqyrojnë momente të ndryshme të jetës së heroit, “Gjon Huniadi” dhe “Një pasqyrë jete njerëzore”.

Te “Gjon Huniadi” që ka në qendër kthimin e heroit në Shqipëri, fantazia e poetit e cenon ndjeshëm historinë, duke e bërë prijësin hungarez Huniad, gati moshatar me Skënderbeun, mjaft të moshuar, të futur në burg nga turqit, mandej të liruar dhe të zënë rob nga Skënderbeu. Po këto ndryshime të historisë kanë si synim nga një anë të spikasë një tipar thellësisht shqiptar i karakterit të Skënderbeut si ndjenja e besës që e ndalon të shfrytëzojë rastin në saje të të cilit i ka rënë në dorë një prijës i rëndësishëm si Huniadi, nga ana tjetër të nënvizojë miqësinë që do të lindë midis këtyre dy udhëheqësve trima dhe të mençur.

Në këtë poemë De Rada zbulon një tipar tjetër të personalitetit të heroit kombëtar, aftësinë për të bërë për vete të tjerët, tipar karakteristik për një udhëheqës popullor në fjalimin që ai u mban trimave të tij para kthimit në Shqipëri, një fjalim të zjarrtë patriotik dhe kushtues, plot patos oratorik, po edhe plot çiltërsi.

Ky fjalim, padyshim, është frymëzuar nga Barleti, ndonëse historiani e vendos në gojën e heroit *pas* kthimit në atdhe dhe dëshmon për talentin prej oratori të Skënderbeut, po njëkohësisht pasqyron me sinjeritet edhe ndjenjat e tij. Forca e komunikimit midis heroit dhe ushtarëve të tij qëndron në një dashuri të vërtetë reciproke, jo në retorikën buçitëse. Kjo evidencohet përmes ballafaqimit me fjalimin që u mban të tijëve pashai turk, që jepet në mënyrë joshmatike si trim dhe i mençur, po edhe si ambicioz i çmendur, që sheh vetëm lavdinë e vet.

Pra, poeti përdor në këtë krijim të vetin parimin e paralelizmit dhe të kontrastit midis karaktereve që të fuqizohen tiparet e personalitetit të heroit.

Në poemën “Një pasqyrë jete njerëzore” Skënderbeu jepet kryesisht në aspektin qytetar. Megjithatë poeti nuk rresht së gërmuari në shpirtin e tij. Ai e pasqyron heroin si një prijës ideal, që refuzon madje një fitore që arrihet me çmimin e një mizorie të panevojshme ndaj armikut (në episodin në të cilin ai qorton rreptë të nipin, Bozdarin, që ka përdorur një dredhi lufte të egër, duke i djegur turqit të gjallë në një ullishte dhe nuk ka pranuar as kërkesat e tyre për t’u dorëzuar).

Heroi tregon në këtë çast, në këndvështrimin e poetit, edhe humanizëm kristian, edhe bujari shqiptare ndaj armikut të mundur dhe sheh tek armiq të edhe thelbin e tyre njerëzor. Autoriteti i tij moral është i tillë sa fjalët e tij tingëllojnë si “e thën mbi lqip”, si këmbanë zie.

Ky autoritet shfaqet gjithashtu kur ai arrin të zhdukë përçarjen në saje të fjalës së vet (episod kur ai ndan dy princat shqiptarë, Dukagjinin dhe Bozdarin që bëhen gati të përleshën në dasmën e tij). Në këtë episod heroit i vihen në gojë fjalë me të cilat ai shpreh synimet e tij për krijimin e një shteti të bashkuar shqiptar.

Një cenim i historisë në këtë episod është prania e Vojsavës, së ëmës së Skënderbeut që në këtë kohë historikisht kishte vdekur. Ky ndryshim i historisë ka si synim evidencimin e autoritetit moral të nënave shqiptare dhe ndikimit të tyre në zbutjen e konflikteve.

De Rada ka një meritë të padiskutueshme në pasurimin e figurës së Skënderbeut në përmasën psikologjike.

Në pasqyrimin e epokës poeti ka vënë re me mprehtësi edhe rolin ambivalent të Venedikut, gjë që evidencohet te “Një pasqyrë jete njerëzore” ku heroit shqiptar Radhavan i thotë një fisniku venedikas që për fatin e vendit duhet të vendosin vetëm shqiptarët.

Në monografinë tonë “Poezia e De Radës” të vitit 1989 kemi thënë se poeti nuk mundi të jepte një pasqyrë të plotë të Shqipërisë në shek. XV dhe nuk e krijoi dot plotësisht figurën e Skënderbeut në përmasat e saj historike. Kemi pranuar mendimin e Markianoit dhe të Gualtierit, që poetit i mungonte ai bagazh njohurish historike, gjeografike që do ta bënte të mundur krijimin e një tabloje të plotë të Shqipërisë së shekullit XV.

Megjithatë De Rada, me gjithë largimet nga historia, e pasqyroi epokën dhe figurën e Skënderbeut më gjerë dhe më thellë se tërë poetët arbëreshë.

Poetët arbëreshë që e pasuan De Radën e shohin Skënderbeun kryesisht në aspektin qytetar, duke e vendosur në situata kyçe si këshilli i luftës apo betejat që jepen në përputhje me ngjarjet historike, betejat e Beratit dhe të Valkalit të Dara, rrethimi i Krujës te Kozmo Serembe dhe Engjëll Noçiti, beteja e Torviollit te Bilota.

Po në realizimin artistik vetëm Dara i Ri i qëndron përballë denjësisht De Radës. Ai e paraqet heroin si udhëheqës ushtarak, duke lënë pas dore aspektin thjeshtësisht njerëzor tek ai. Skënderbeu i Darës pasqyrohet kryesisht në marrëdhënie me bashkëluftëtarët dhe me armiqtë si njeri i veprimit dhe jo i fjalës që ka një ndikim të madh tek të tjerët, që karakterizohet nga një empati me të cilën ai kupton ndjenjat e tyre, prandaj ai mundohet t’ia zbutë plagët e ndërgjegjes Moisi Golemit, të cilin e ka falur, e lejon Nikun të shkojë të çlirojë Marën, po edhe e këshillon të ruhet nga guximi i tepruar. Prandaj edhe mjetet e portretizimit, që përdor, ndryshojnë nga ato që shohim tek De Rada: ai e vizaton heroin përmes dialogut dhe veprimit, kurrë përmes monologut të brendshëm.

Skënderbeu i Darës jepet si figurë e formuar, nuk ka asnjë çast dyshimi, aq më pak konflikti shpirtëror. Është një njeri me vullnet të fortë deri në

heroizëm që ndikon tek të tjerët me forcën e karakterit të vet po di edhe të jetë i butë kur e kërkon situata.

Dara distancohet nga heroi i vet, nuk i jep diçka nga “vizioni i vet i jetës” si De Rada.

Bilota, K. Serembe, E. Noçiti synojnë edhe më drejt objektivitetit në paraqitjen e figurës së Skënderbeut që jepet si udhëheqës ushtarak dhe strateg i lidhur me popullin. Bilota dhe Serembe ndiejnë ndikimin e poezisë antike dhe eposit kalorësiak dhe e modelojnë Skënderbeun e tyre në bazë të figurave të klasicizmit që përzihet me romantizmin dhe i jep Skënderbeut të tyre një farë përsosmërie të mermertë. Po secili prej tyre zbulon aspekte të reja të epokës. Bilota nënvizon rolin e Skënderbeut si kalorës të krishterimit dhe e sheh edhe aspektin fetar të luftës. Kozmo Serembe jep skena konkrete të rolit të grave të thjeshta shqiptare gjatë luftimeve.

Noçiti në poemthin origjinal të zbuluar nga studiuesi Fortino “Ndihma e Krujës” paraqet konkretisht strategjinë luftarake të Skënderbeut, ndonëse, duke ndryshuar historinë, e paraqet heroin, duke qëndruar brenda në qytet bashkë me popullin në vend që të qëndronte jashtë, siç pohon Barleti dhe të tmerronte armikun me sulme të papritura. Ky ndryshim do të nënvizojë unitetin e heroit me popullin. Gjithashtu zbulohet një aspekt i ri, roli i agentëve në luftë nëpërmjet figurës dhe linjës së ndërlidhësit Shale. Noçiti zbulon dinjitetin me të cilin heroi respekton të drejtat e atyre që e rrethojnë (ndomos – rregj – ndonëse mbret, shton poeti). Poemthi i tij ka një strukturë të re, një fund të “hapur”. Fitorja nuk jepet, po vetëm paralajmërohet, çka thekson besimin te zotësia e prijësit.

Është karakteristike që Dara dhe Noçiti e quajnë Skënderbeun “mbret”, titull që historikisht ai s’e pati, po deshën të mishërojnë përmes këtij detaji faktin që ai ishte mbreti ideal, që u duhej shqiptarëve.

Ndonëse besnikëria ndaj epokës dhe figurës së Skënderbeut u cenua, jo rrallë, nga fantazia, në veprat e poetëve arbëreshë që plotësuan njeri-tjetrin, u zbuluan në thelb përmasat objektive të figurës së heroit si prijës që arriti bashkimin e një kombi të përçarë, që përballoi për një çerek shekulli me sukses një luftë të pabarabartë, duke u mbështetur në të gjitha shtresat e popullit dhe arriti të shpëronte kulturën evropiane.

SUMMARY

FANTASY AND LOYALTY IN REFLECTIONS OF THE SKANDERBEG ERA AND HIS FIGURE IN ARBËRESH LITERATURE

This paper examines from a new perspective the problem of reflecting Scanderbeg era and figure in Arbëresh literature, something which has been

investigated by various scholars. Under investigation here is the relationship between the reflection of historical reality in terms of *mimesis* (the most faithful reproduction of the reality) and artistic transformation, based on writer's ideals.

Historical hays are in themselves a composition between literature and history. Close faithfulness/loyalty to history is not indispensable, but the risk of excessive idealism or the myth of historical figures, which in today's terms is perceived by the most professional reader, must be avoided.

This study mentions great figures such as Girolamo De Rada, Gabriele Dara, Giuseppe Schirò, less Giuseppe Serembe, who accepted the challenge of drawing the figure of the National Hero and drew it in a very original way. Writers not so much known as well have been taken into consideration, such as Cosmo Serembe, Bernardo Bilotta, Angelo Nociti, who approached the historical reality in their epic poems and dealt with special aspects of Skanderbeg era and figure, which were set aside by their outstanding compatriots.

The paper analyses poems, lyrics and historical novels of the above-mentioned authors, as well as pseudo-historical works, such as those of the incredibly prolific writer Santori.

Skanderbeg's figure has been portrayed as a leader, a statesman who defended and united Albanians, as well as a Christian knight and protector of European culture.

Arbëresh literary works show the Skanderbeg's image as a myth, consistent with the patriotic message and romantic spirit, but they also reflect a goal to discover in him the objective essence as a historical figure and as a human being.